

## Masa paraprake për pleqëri

Me masat paraprake për pleqëri sigurohet, që të pensionuarve iu mbeten mjaft para për të jetuar. Sistemi zviceran i masave paraprake ka tri shtylla: Sigurimi i pensionit në pleqëri dhe i personave të lënë pas (AHV), masa paraprake në profesion (arka e pensionit) dhe masa paraprake vullnetare për pleqëri (shtylla nr. 3).

### **Sigurimi i pensionit në pleqëri dhe i personave të lënë pas (shtylla nr. 1, 1. Säule)**

Sigurimi i pensionit në pleqëri dhe i personave të lënë pas (AHV) është një institucion shtetëror. Shumica e personave të rritur duhet të paguajnë kontribute për këtë. Shumat zbriten te të punësuarit çdo muaj direkt nga rroga, punëdhënësi merr përsipër gjysmën. Të vetëpunësuarit apo personat pa vend pune duhet të pyesin në arkën e balancimeve (Ausgleichskasse), se si duhet t'i paguajnë kontributet e tyre. AHV iu paguan pensionistëve një pension mujor. Lartësia e pensionit varet prej shumës, e cila është paguar. Edhe në rast vdekjeje, AHV i mbështet bashkëshortët dhe fëmijët e personit të vdekur (Pension për të veja dhe vejanë dhe për jetimë). Secili dhe secila merr një letërnjoftim AHV me numrin personal të sigurimit.

### **Masë paraprake profesioni (shtylla nr. 2, 2. Säule)**

AHV-ja vetë zakonisht nuk mjafton, që jeta të vazhdohet mbas pensionimit si më parë. Prandaj për të punësuarit ekziston edhe një masë paraprake në profesion (arka e pensionit, Pensionskasse), e cila është e detyrueshme për të gjithë ata, që kalojnë një shumë të të ardhurave vjetore. Kontributet zbriten përmuajshëm direkt nga rroga, punëdhënësi duhet të paguajë të paktën gjysmën. Të vetë-punësuarit nuk duhet të paguajnë kontribute. Sado ata mund ta bëjnë vullnetarisht, ata mbajnë vetë përgjegjësi në këtë pikë. Në pleqëri, paratë e kursyera në arkën e pensionit paguhen ose si pension ose mund të tërhiqen menjëherë. Në raste të caktuara, paratë mund të tërhiqen edhe më herët: Kur dikush themelon një firmë të veten, kur dikush shpërngulet nga Zvicra, kur dikush ndërton një shtëpi për vete apo blen një banesë.

### **Masë vullnetare paraprake për pleqëri (shtylla nr. 3, 3. Säule)**

Te shtylla nr. 3 (3. Säule) bëhet fjalë për një masë paraprake private për pleqëri, e cila është vullnetare dhe shpërblehet me zbritje në tatimit. Kontrata të tilla mund të lidhen me banka apo sigurime. Rekomandohet që të kursehen para në shtyllën nr. 3, në mënyrë të ketë një rezervë në pleqëri.

## **Shërbimet plotësuese**

Njerëzit e moshuar, që me gjithë AHV dhe arkën së pensionit nuk kanë para të mjaftueshme që të jetojnë, kanë sipas rrethanave të drejtë për përfitime plotësuese financiare (Ergänzungsleistungen). Për ta duhet të aplikohet në entin për kontribute sociale. Është e rregulluar qartazi, se kush ka të drejtë për marrjen e shërbimeve financiare plotësuese. Shërbimet plotësuese financohen prej taksapagueseve dhe taksapaguesve.

## **Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)**

[www.hallo-baselstadt.ch/sq/siguria-sociale/mase-paraprake-per-pleqeri](http://www.hallo-baselstadt.ch/sq/siguria-sociale/mase-paraprake-per-pleqeri)